

VENDIM
Nr. 504, datë 24.6.2020

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE,
TË CILËT STUDIOJNË JASHTË VENDIT, DHE SHTETASVE TË HUAJ ME
ORIGINË SHQIPTARE, TË CILËT PËRFITOJNË BURSA NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”; të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”; të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

2. Baza e të dhënave shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përmban të dhëna personale, për:

- a) shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet e arsimit të lartë jashtë vendit;
- b) shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;
- c) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit, të cilat u ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. Të dhënat që përmban baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijojnë:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna, të cilat grumbullohen nga ky regjistër dhe përfshijnë:

- i. periudhën e studimeve;
- ii. shtetin pritës;
- iii. institucionin e arsimit të lartë pranë të cilit studion;
- iv. fushën e studimeve;
- v. burimin e financimit të bursës;
- vi. adresën e postës elektronike (*email*);
- vii. të dhënat e shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij vendimi:

- emri;
- mbiemri;
- atësia;
- adresa;
- gjinia;
- vendlindja;
- datëlindja.

b) Të dhënat dytësore, që shkëmbehen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGJC), janë si më poshtë vijojnë:

- i. NID-i i shtetasit;
- ii. emri;
- iii. mbiemri;

- iv. atësia;
- v. adresa;
- vi. gjinia;
- vii. vendlindja;
- viii. datëlindja.

4. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

5. Baza e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGjC) dhe *database*-t e tjera shtetërore, të cilat, në aktin e krijimit të tyre, parashikojnë ndërveprimin me bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

6. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

7. Vlerësimi i rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, realizohet nga një komision i veçantë me 9 (nëntë) anëtarë, nga institucionet përgjegjëse, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ai drejtohet nga ministri përgjegjës për diasporën. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. Dhënia e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe rregullohet me akte të tjera.

8. Baza e të dhënave shtetërore aksesohet nga të gjitha institucionet e interesuara nëpërmjet kërkesës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama